

BANKA CREDINS SH.A.

**Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2008
(me raportin e auditorit të pavarur bashkangjitur)**

Përmbajtja

	Faqe		Faqe
Raporti i auditorit të pavarur		4. Administrimi i rezikut financiar	
Pasqyrat financiare		(a) Një vështrim i përgjithshëm	21
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	1	(b) Risku i kreditimit	21
Bilanci	2	(c) Risku i likuiditetit	26
Pasqyra e ndryshimit në kapital	3	(d) Risku i tregut	28
Pasqyra e flukseve të parasë	4	(e) Manaxhimi i kapitalit	31
Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare		5. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve	33
1. Njësia raportuese	5	6. Paraqitja me vlerën e drejtë	34
2. Bazat e përgatitjes		7. Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa	35
(a) Deklarata e përputhshmërisë	5	8. Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet	35
(b) Bazat e matjes	5	9. Shpenzime personeli	36
(c) Monedha funksionale dhe raportuese	5	10. Shpenzime administrative	36
(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve	5	11. Tatimi mbi fitimin	37
3. Përmbledhje e politikave të kontabël		12. Aktivët monetare dhe ekuivalente me to	37
(a) Transaksionet në monedhë të huaj	6	13. Shuma të kushtëzuara me Bankën Qëndrore	37
(b) Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi	6	14. Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve financiare	38
(c) Tarifat dhe komisionet	6	15. Hua dhe paradhënie bankave	38
(d) Pagesat e qirasë	7	16. Investime në letra me vlerë	39
(e) Tatim mbi fitimi	7	17. Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	41
(f) Aktivët dhe detyrimet financiare	8	18. Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	42
(g) Aktive monetare dhe ekuivalente me to	10	19. Tatimi i shtyrë aktiv	43
(h) Huat dhe paradhënie klientëve	11	20. Aktive për shitje	43
(i) Investime në letra me vlerë	11	21. Aktive të tjera	43
(j) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	12	22. Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	44
(k) Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	13	23. Detyrime ndaj klientëve	44
(l) Aktivët me qira	13	24. Borxhi i varur	45
(m) Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare	13	25. Detyrime të tjera	46
(n) Depozitat dhe borxhi i varur	14	26. Kapitali aksioner	46
(o) Provigjione	14	27. Rezerva e përgjithshme	47
(p) Garancitë financiare	15	28. Transaksionet me palët e lidhura	47
(q) Përfitimet e punonjësve	15	29. Garanci dhe angazhime	48
(r) Netimi i operacioneve në monedhë të huaj	15	30. Shpjegime për kalimin në SNRF	49
(s) Aktivët për shitje	15	31. Ngjarjet pas bilancit	53
(t) Ri lëshimi i pasqyrave financiare	16		
(u) Standarte, interpretime dhe amendime të reja ndaj Standarteve të publikuara që nuk janë akoma efektive dhe që janë relevante ndaj aktiviteteve të Bankës	17		



KPMG Albania Sh.p.k.
"Dëshmorët e Kombit" Blvd.
Twin Towers Buildings,
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania
NIPT J91619001D

Telephone +355 4 2274 524
+355 4 2274 534
Telefax +355 4 2235 534
E-mail al-office@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Raport i Audituesit të Pavarur

Tiranë, 6 Korrik 2009

Pronarëve të Banka Credins Sh.a

Ne kemi audituar bilancin kontabël bashkëlidhur të Banka Credins Sh.a ("Banka") për ushtrimin e mbyllur me datë 31 Dhjetor 2008 dhe pasqyrat përkatëse të të ardhurave, ndryshimet e kapitalit dhe të fluksit të parasë për fundin e vitit dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe shënime të tjera sqaruese.

Pergjegjesia e Drejtimit per Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në pajtim me Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe ruajtjen e kontrollit të brendshëm, i cili është i rëndësishëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare pa anomali materiale, që mund të jenë pasojë e gabimeve apo mashtrimit; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave kontabël të duhura; dhe bërjen e çmuarjeve kontabël të cilat janë të arsyeshme për rrethanat.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në pajtim me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne t'u përmbahemi kërkesave etike të përshtatshme dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të fituar siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencë që mbështet tepricat dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura janë në varësi të gjykimit tonë, përfshirë këtu vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, prej gabimit apo mashtrimit. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, ne shqyrtojmë kontrollin e brendshëm, i cili është i rëndësishëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por që nuk kanë për qëllim shprehjen e një opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë. Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve kontabël të përdorura dhe të çmuarjeve të rëndësishme të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca që mbështet tepricat dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare jep një bazë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për opinionin tonë.

Opinionit

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë për gjendjen financiare të Bankës me datë 31 Dhjetor 2008, për rezultatet e veprimtarive të saj dhe flukset e parasë për ushtrimin e mbyllur, në pajtim me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Theksimi i çështjes

Pa e kualifikuar opinionin tonë, tërheqim vëmendjen në Shënimin 3.t të pasqyrave financiare. Opinioni ynë në datë 8 Maj 2009 u shpreh me rezervë sepse nuk mundëm të mblidhnim evidencë të mjaftueshme dhe të kënaqshme për gjykimin e Drejtimit të Bankës mbi mundësinë e mbledhjes së kredive dhe paradhënieve dhënë klientëve për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008 dhe 31 Dhjetor 2007. Për më tepër ne vumë re që Banka kishte përdorur një metodë llogaritjesh e cila, sipas mendimit tonë, nuk ishte në përputhje me SNK 39 “Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja”. Pas kësaj date, Banka paraqiti një metodologji të përshtatshme siç është shpjeguar në shënimin 3.t të pasqyrave financiare. Banka lëshoi edhe një herë pasqyrat financiare si dhe korrigjoi sipas llogaritjeve të reja provigjionin për humbje kolektive nga kreditë dhe paradhëniet klientëve për fund vitin 31 Dhjetor 2008 and 2007.

KPMG Albania Sh.p.k.

KPMG Albania Sh.p.k.
“Dëshmorët e Kombit” Blvd.
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana
Albania

BANKA CREDINS SH.A.


Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve më 31 Dhjetor 2008

(në Lek '000)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2008	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2007
Të ardhura nga interesat	7	3,287,020	2,429,031
Shpenzime për interesa	7	(1,533,054)	(1,200,165)
Të ardhura neto nga interesat	7	1,753,966	1,228,866
Të ardhura nga komisionet	8	217,738	141,520
Shpenzime për komisionet	8	(30,841)	(29,059)
Të ardhura neto nga komisionet	8	186,897	112,461
Shpenzime të tjera, neto		(3,280)	(2,683)
Fitim/(humbje) nga kembimet valutore		205,737	(75,285)
Të ardhura të tjera nga aktivitetet bankare		202,457	(77,968)
Humbje neto nga zhvlerësimi i huave	15	(341,528)	(34,716)
Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	18	(8,122)	(8,852)
Zhvlerësim i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	17	(113,752)	(88,020)
Shpenzime personeli	9	(385,141)	(265,610)
Shpenzime administrative	10	(472,093)	(349,431)
		(1,320,636)	(746,629)
Fitimi para tatimit		822,684	516,730
Tatimi mbi fitimin	11	(83,751)	(138,659)
Fitimi neto i periudhës		738,933	378,071

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve të lexohet e ndërthurur me shënimet shoqëruese si pjesë përbërëse e pasqyrave, të paraqitura nga faqja 5 deri ne faqen 53.

Këto pasqyra financiare u miratuan nga Bordi i Drejtuesve të Bankës me 6 July 2009 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:



Artan Santo
Drejtore i Përgjithshëm



Valentina Prodan
Drejtore e Finances dhe
Kontabilitetit

BANKA CREDINS SH.A.

Bilanci më 31 Dhjetor 2008

(në Lek '000)

	Shënime	31 Dhjetor 2008	31 Dhjetor 2007
Aktivët			
Aktive monetare dhe ekuivalente me to	12	6,821,784	8,326,436
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore	13	3,250,567	2,783,889
Hua dhe paradhënie bankave	14	748,214	1,420,529
Hua dhe paradhënie për klientët	15	24,436,133	15,864,091
Investime në letra me vlerë	16	3,891,698	6,429,493
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	17	774,697	677,929
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	18	36,078	36,461
Tatimi i shtyrë aktiv	19	51,712	33,289
Parapagimi i tatimit mbi fitimin		1,086	-
Aktive për shitje	20	56,655	7,280
Aktive të tjera	21	197,047	140,869
Totali i aktiveve		40,265,671	35,720,266
Detyrimet			
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	22	1,241,551	1,768,376
Detyrime ndaj klientëve	23	34,572,233	31,221,235
Borxhi i varur	24	1,274,970	735,843
Detyrimi për tatimin mbi fitimin		-	33,018
Detyrime të tjera	25	25,659	46,922
Totali i Detyrimeve		37,114,413	33,805,394
Kapitali aksioner			
Kapitali i paguar	26	2,119,762	1,598,110
Primi i emetimit		336,334	84,814
Rezerva e përgjithshme	27	258,618	-
Rezerva të tjera		(299,605)	(146,123)
Rivlerësimi i letrave me vlerë	16.1	(2,784)	-
Fitime të mbartura		738,933	378,071
Totali i kapitalit aksioner		3,151,258	1,914,872
		40,265,671	35,720,266

Pasqyra e Bilancit të lexohet e ndërthurur me shënimet shoqëruese si pjesë përbërëse e pasqyrave, të paraqitura nga faqja 5 deri në faqen 53.

BANKA CREDINS SH.A.

Pasqyra e ndryshimit të kapitalit per vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008
(në Lek '000)

	Kapitali i paguar	Primi i aksioneve	Rezerva e përgjiths hme	Rezerva të tjera	Rivlerësimi i letrave me vlerë	Fitime të mbajtura	Totali i kapitalit
Gjendja më 1 Janar 2007	1,369,415	84,814	-	(113,242)	-	195,814	1,536,801
Përvetësimi i fitimit të akumuluar	228,695	-	-	(32,881)	-	(195,814)	-
Fitimi neto i periudhës	-	-	-	-	-	378,071	378,071
Gjendja më 31 Dhjetor 2007	1,598,110	84,814	-	(146,123)	-	378,071	1,914,872
Përvetësimi i fitimit të akumuluar	272,935	-	258,618	(153,482)	-	(378,071)	-
Rritje në kapitalin e paguar	248,717	251,520	-	-	-	-	500,237
Rivlerësimi i letrave me vlerë të vlefshëm për shitje	-	-	-	-	(2,784)	-	(2,784)
Fitimi neto i periudhës	-	-	-	-	-	738,933	738,933
Gjendja më 31 Dhjetor 2008	2,119,762	336,334	258,618	(299,605)	(2,784)	738,933	3,151,258

Pasqyra e ndryshimit të kapitalit të lexohet e ndërthurur me shënimet shoqëruese si pjesë përbërëse e pasqyrave, të paraqitura nga faqja 5 deri ne faqen 53.

BANKA CREDINS SH.A.

Pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008
(në Lek '000)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2008	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2007
Flukset e arkës nga aktivitetet operative			
Fitimi neto i periudhës		738,933	378,071
<i>Korrigjime për :</i>			
Zhvlerësimin dhe amortizimin	17,18	121,874	96,872
Aktivitet e trupëzuara të nxjerra jashtë bilancit	17,18	3,385	5,552
Zhvlerësimi i instrumentave financiarë	15	341,528	34,716
Hua të fshira	15	(1,252)	(7,208)
Te ardhura nga interesat, neto	7	(1,753,966)	(1,192,576)
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	11	83,751	138,659
Ndryshimi në hua dhe paradhënie bankave		677,637	(1,012,650)
Ndryshimi në hua dhe paradhënie klientëve		(8,873,701)	(4,788,184)
Ndryshimi në shumatat e kushtëzuara me Bankën Qendrore		(466,578)	(607,192)
Ndryshimi në aktive të tjera		(56,178)	227,037
Ndryshimi në detyrimet ndaj bankave		(522,209)	694,491
Ndryshimi në detyrimet ndaj klientëve		3,213,769	7,219,900
Ndryshimi në detyrimet e tjera		(21,263)	24,928
Interesi i arkëtuar		3,333,916	2,266,343
Interesi i paguar		(1,378,380)	(1,020,001)
Tatim fitimi i paguar		(136,278)	(126,268)
Flukset e arkës (përdorur)/gjeneruar nga aktivitetet operative		(4,695,012)	2,332,490
Flukset e arkës nga aktivitetet investuese:			
Shitja/(blerja) e Letrave me vlerë		2,444,074	(779,778)
Rritja në aktivitet për shitje		(49,375)	(7,280)
Blerje e aktiveve të qëndrueshme të trupezuara	17	(213,901)	(204,994)
Blerje e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara	18	(7,743)	(15,136)
Flukset e arkës të gjeneruara / përdorur në aktivitetet investuese		2,173,055	(1,007,188)
Flukset e arkës nga aktivitetet financuese			
Rritje në borxhin e varur		517,066	205,670
Pakësimi në fondin special		-	(197,863)
Kapitali i paguar		500,239	-
Flukset e arkës gjeneruar nga aktivitetet financuese		1,017,305	7,807
(Pakësimi)/ Rritja në para gjatë vitit		(1,504,652)	1,333,109
Aktive monetare dhe ekuivalente me të më 1 Janar		8,326,436	6,993,327
Aktive monetare dhe ekuivalente me të më 31 Dhjetor	12	6,821,784	8,326,436

Pasqyra e flukseve të parasë të lexohet e ndërthurur me shënimet shoqëruese si pjesë përbërëse e pasqyrave, të paraqitura nga faqja 5 deri në faqen 52.

BANKA CREDINS SH.A.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

1. Njësia raportuese

Banka Credins Sh.a. (që në vazhdim, do t'i referohemi si "Banka") është një institucion financiar i themeluar më 1 Prill 2003 në bazë të ligjit tregtar në Shqipëri dhe është licencuar nga Banka e Shqipërisë më datë 31 Mars 2003 për të ushtruar aktivitetin e saj si bankë në të gjitha fushat e aktivitetit bankar në Shqipëri në përputhje me Ligjin nr. 8365 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", miratuar në Korrik 1998. Banka është gjithashtu subjekt i Ligjit nr. 8269, miratuar në Dhjetor 1997, "Mbi Bankën e Shqipërisë".

Më 31 Dhjetor 2008, Banka ushtronte aktivitetin e saj nëpërmjet drejtorisë së përgjithshme në Tiranë, 26 degëve në Tirane, Durrës, Fier, Lezhë, Elbasan, Vlore, Shkoder, Korce, Shijak, Shkozë, Kavajë dhe Lushnjë si edhe tre agjensive në Tiranë dhe një në portin e Durrësit.

Më 31 Dhjetor 2008 Banka kishte 386 punonjës (31 Dhjetor 2007: 275 Punonjës).

2. Bazat e përgatitjes

a) Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), Duke filluar nga 1 janari 2008, aplikimi i SNRF-ve u bë kërkesë ligjore raportimi për Bankën. Banka adopton për herë të parë SNRF-të. Në shënimin 30 është shpjeguar sesi kalimi në SNRF ka ndikuar në pozicionin financiar të raportuar në balancat e hapjes më 1 Janar 2007 dhe performancën financiare të Bankës për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2007.

b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike përveç atyre instrumenteve financiare që janë matur me vlerë të drejtë.

c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale e Bankës. Përveç rasteve kur shprehet ndryshe, informacioni financiar i prezantuar është në Lek i rrumbullakosur në mijëshen më të afërt.

d) Përdorimi i vlerësimit dhe gjykimit profesional

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga vlerësimet. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.

Në veçanti, informacion mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël të njohura në pasqyrat financiare paraqitet në shënimin 5.

Politikat kontabël të vendosura më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente nga Banka në të gjitha periudhat dhe në përgatitjen e balancave të hapjes sipas SNRF-ve më 1 Janar 2007 për qëllime të kalimit në SNRF.

BANKA CREDINS SH.A.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj kthehen në monedhën funksionale të Bankës me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, aktivet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj rivlerësohen në Lek me kursin në datën e bilancit.

Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës të rregulluara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fund-vitit.

Për më tepër, shpenzimet për humbjet nga zhvlerësimi i huave, provigjionet për garancitë e klientëve dhe fondi special i krijuar nga aksionerët, të gjitha të nominuara në valutë, përkthehen me kursin e këmbimit në datën e raportimit.

Kurset e këmbimit të aplikueshme (Lek ndaj njësisë së monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 Dhjetor 2008 dhe 31 Dhjetor 2007 ishin si më poshtë:

	31 Dhjetor 2008	31 Dhjetor 2007
USD	87.91	82.89
EUR	123.80	121.78
GBP	127.66	166.02
CHF	82.97	73.65
CAD	72.22	84.45

b) Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesa njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që aktualizon pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së mjetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme për një periudhë më të shkurtër) për ti barazuar me vlerën kontabel të mjetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit vendoset duke marrë parasysh njohjen fillestare të aktiveve ose detyrimeve financiare dhe nuk rishikohet më vonë.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha shumat e paguara ose të marra në avancë, kostot e transaksionit, zbritjet dhe primet të cilat janë pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, ose emetimin apo nxjerrjen jashtë bilancit të një mjeti apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet për interesat të prezantuara në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përfshin interesin e aktiveve dhe detyrimeve financiare me kosto të amortizuar me normë interesi efektive

c) Tarifat dhe komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet për tarifën dhe komisionet të cilat janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv në një mjet ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të tjera tarifa dhe komisione që përfshijnë tarifa për shërbimin e llogarive, tarifa për administrimin e investimeve, komision shitje, tarifën e vendosjes dhe përfaqësimit njihen ndërsa shërbimi i lidhur kryhet.

Shpenzime të tjera për komisionet dhe tarifën që lidhen kryesisht me komisione transaksionesh dhe shërbimi shpenzohet në momentin që ofrohen shërbimet

BANKA CREDINS SH.A.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

3 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

d) Pagesat e qirasë

Pagesat e bëra për qiranë operative janë njohur në të ardhura dhe shpenzime në bazë të metodës lineare mbi jetëgjatësinë e qirasë. Zbritje nga qiraja njihen si pjesë përbërëse e totalit të shpenzimit të qirasë gjatë jetës së qirasë.

e) Tatim mbi fitimi

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zërat e kapitalit e cila njihet direkt në kapital.

Tatimi aktual është tatimi që pritët të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet si e tillë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar. E ardhura e tatueshme llogaritet duke korrigjuar fitimin sipas raportimit për qëllime ligjore para tatimeve për disa zëra të të ardhurave dhe shpenzimeve siç kërkohet nga ligji shqiptar.

Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur metodën e bilancit, nga diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore. Shuma e tatimit të shtyrë është llogaritur duke përdorur normën tatimore në fuqi në datën e mbylljes së diferencave, sipas ligjeve në fuqi në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet në masën që mund të përdoret kundrejt fitimit të tatueshëm në të ardhmen. Aktiv tatimor i shtyrë zvogëlohet për pjesën që nuk mund të përdoret për përfitime tatimore.

BANKA CREDINS SH.A.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

f) Aktivet dhe detyrimet financiare

i) Njohja

Huatë dhe paradhëniet klientëve, depozitat e klientëve dhe borxhi i varur njihen fillimisht në datën e krijimit. Të gjitha aktivet dhe detyrimet financiare të tjera njihen fillimisht në datën kur Banka bëhet palë kontraktuale e një instrumenti.

ii) Klasifikimi

Shih politikat kontabel 3(g),(h),(i) dhe (n)

iii) Ç'regjistrimi

Aktivet financiare ç'regjistrohen nëse të drejtat kontraktuale të Bankës ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar mbarojnë, ose nëse Banka i transferon të drejtat për të arkëtuar flukse nga aktivi financiar një pale tjetër, duke transferuar të gjitha risqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin. Çdo interes në aktivet financiare të transferuara që përfitohet ose mbahet nga Banka njihet si një aktiv ose detyrim më vete.

Detyrimet financiare ç'regjistrohen nëse detyrimet e Bankës të detajuara në kontratë përfundojnë, janë shlyer ose janë anuluar.

Banka merr pjesë në transaksione me anë të të cilave transferon aktive të njohura në bilancin e saj kontabël, por mban në të njëjtën kohë të gjitha risqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin e transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse të gjitha risqet dhe përfitimet mbahen, atëherë aktivet e transferuara nuk çregjistrohen nga bilanci. Transferimi i aktiveve për të cilat mbahen të gjitha risqet dhe përfitimet përfshin, për shembull huadhënien dhe riblerjen e letrave me vlerë.

Nëse aktivet financiare i shiten palëve të treta me një normë totale kthimi në këmbim ('seap'), transaksioni regjistrohet si një huadhënie e siguar, e ngjashme me marrëveshjet e riblerjes. Transaksionet, në të cilat Banka as nuk mban dhe as nuk transferon risqet dhe përfitimet e lidhur me aktivin financiar, e çregjistrojnë aktivin nëse humbet kontrollin mbi të. Në transaksione në të cilat Banka as nuk mban dhe as nuk transferon risqet dhe përfitimet e pronësise mbi aktivet financiare, e çregjistrojnë aktivin nëse kontrolli mbi të humbet. Të drejtat dhe detyrimet e mbajtura gjatë transferimit njihen më vetë si aktive ose detyrime sipas rastit. Në transferimet e aktiveve mbi të cilat mbahet kontrolli Banka vazhdon ta njohë aktivin deri në momentin e përfshirjes së saj, e përcaktuar kjo nga koha gjatë së cilës Banka është e ekspozuar ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivit të transferuar. Në disa transaksione, Banka mban të drejtat për të marrë ose kryen shërbime për një aktiv financiar të transferuar kundrejt një tarife. Aktivi i transferuar ç'regjistrohet në tërësi nëqoftëse ai i përmbush kriteret e ç'regjistrimit. Një aktiv ose detyrim njihet për të drejtat për shërbimin, nëqoftëse tarifa e shërbimit është më e lart se shpenzimet e shërbimit (aktiv) ose është më pak se e përshtatshme për të kryer shërbimin (detyrim).

iv) Netimi

Aktivet dhe detyrimet financiare netohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në bilanc atëherë dhe vetëm atëherë kur Banka ka të drejtën ligjore për të netuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standartet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme si ato në aktivitetin tregtar të Bankës.

BANKA CREDINS SH.A.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

3 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

f) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

iv) Matja me kosto të amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi njihet në momentin fillestar duke i zbritur pagesat e principalit, plus/minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

v) Matja me vlerë të drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare bazohet në çmimet e kuotuar të tregut ose çmimet e agjentëve të shitjes për instrumenta financiarë të tregëtueshme në tregje aktive. Për të gjitha instrumentat e tjerë financiarë vlera e drejtë përcaktohet mbi bazën e teknikave të vlerësimit. Metodot e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e flukseve monetare të skontuara, dhe krahasimin me instrumenta të tjerë të ngjashëm për të cilat ekzistojnë çmime tregu dhe metoda vlerësimi. Banka përdor gjerësisht metodat e vlerësimit për të përcaktuar vlerën e drejtë të instrumentave financiarë të zakonshëm e të thjeshtë si opsionet e normat e interesit dhe *swap*-e të monedhës. Për të tilla instrumenta të dhënat për tu përdorur në modelet e vlerësimit janë lehtësisht të vëzhgueshme në treg.

Për instrumenta më kompleks, Banka përdorë modele të çertifikuara, që janë rrjedhojë e përmirësimeve të modele të mirënjohura. Disa ose të gjithë të dhënat e përdorura në këto modele mund të mos jenë të vëzhgueshme dhe janë të rrjedhura nga çmimet ose normat e tregut ose janë të vlerësuara duke u bazuar në supozime. Kur Banka bëhet palë në një transaksion, instrumenti financiar njihet fillimisht me çmimin e transaksionit, që është edhe treguesi më i mirë i vlerës së drejtë, megjithëse vlera e përfutur nga modeli i vlerësimit mund të ndryshojë nga çmimi i transaksionit. Kjo diferencë fillestare në vlerën e drejtë përcaktuar nga teknikat e vlerësimit njihet në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fakteve dhe rrethanave të çdo transaksioni, kur të dhënat e tregut bëhen të vëzhgueshme dhe jo më vonë.

Vlera e nxjerrë nga një model ose nga teknikat e vlerësimit korrigjohet me një numër të caktuar faktorësh më të përshtatshëm, sepse teknikat e vlerësimit nuk mund të reflektojnë siç duhet të gjithë faktorët e tregut që merren parasysh në një transaksion. Korrigjimet e vlerësimit përdoren për të përshtatur modelet me riskun, marzhin kërkese-ofertë, riskun e likuiditetit si edhe faktorë të tjerë. Menaxhimi beson se këto korrigjime vlerësimi janë të nevojshme dhe të përshtatshme për të paraqitur me vlerë të drejtë instrumentat financiarë në pasqyra.

vi) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë bilanci Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitim humbjes janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen kur ka evidence që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit, dhe kjo ka një ndikim në flukset e ardhshme të parasë së aktivit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Banka vlerëson mundësinë e zhvlerësimit të aktiveve të saj individualisht dhe në grup gjithashtu. Të gjitha aktivet financiare që kanë një vlerë të konsiderueshme, testohen individualisht për zhvlerësim. Të gjitha aktivet e testuar individualisht dhe jo të zhvlerësuara, grupohen dhe testohen për ndonjë zhvlerësim të ndodhur por të paidentifikuar ende. Aktivet të cilat nuk janë individualisht të konsiderueshme trajtohen së bashku për zhvlerësim duke u grupuar në aktive financiare (të mbajtura me kosto të amortizuar) me karakteristikë të njëjta risku.

BANKA CREDINS SH.A.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

f) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

vi) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (vazhdim)

Si evidencë objektive që aktivet financiare (përfshirë edhe letrat me vlerë të kapitalit) janë të zhvlerësuar mund të përfshihen vonesa në pagim ose shkelje nga huamarrësit, ristrukturimi i termave të një huaje ose paradhënie në kushte të pafavorshme për Bankën, të dhëna që një huamarrës ose huadhënës po falimenton, zhdukja e një tregu aktiv për një leter me vlerë, ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si psh ndryshime të pafavorshme të aftësive paguese të një huamarrësi ose huadhënësi ose kushtet ekonomike që tregojnë për mospagime.

Për trajtimin e zhvlerësimit në grup Banka përdor modelimin statistikor të trendave historike të propabilitetit të mospagimit, kohës së rekuperimit dhe vlerën e humbjes së ndodhur, përshtatur me gjykimin menaxherial nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kreditit janë të tilla që humbjet aktuale të jenë më të mëdha ose më të vogla se ato të përcaktuara nga modelimet historike. Pobabiliteti i mospagimit, normat e humbjes dhe përcaktimi i kohës së rekuperimit krahasohen përkundrejt rezultateve aktuale për të siguruar që ato të mbeten të duhurat.

Humbjet nga zhvlerësimi të aktiveve të mbajtura me kosto të amortizuar llogariten si difference e vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të skontuara me vlerën origjinale të interesit efektiv të këtyre aktiveve. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve dhe pasqyrohen në një llogari fondi për humbjet nga zhvlerësimi përkundrejt huave dhe parapagimeve. Interesat mbi aktivet e zhvlerësuar vazhdojnë të njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kur një ngjarje pas datës së bilancit shkakton uljen e humbjes nga zhvlerësimi, kjo ulje reflektohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Humbjet nga zhvlerësimi për investime në letrat me vlerë të vlefshme për shitje njihen duke transferuar diferencën midis koston së blerjes të amortizuar dhe vlerës së drejtë aktuale nga kapitali në pasqyrën e të ardhurave. Kur ngjarje të mëvonshme shkaktojnë një zhvlerësim në letrat me vlerë të borxhit, kjo humje njihet në pasqyrën e të ardhurave.

Sidoqoftë, çdo rimarrje e mëvonshme e vlerës së drejtë të letrës me vlerë të kapitalit të vlefshme për shitje njihet në kapital. Ndryshimet në provigjion për zhvlerësim që i atribuohen vlerës së kohës reflektohen si një komponent i të ardhurës nga interesi.

g) Aktive monetare dhe ekuivalente me to

Aktive monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë kartëmonedha, monedha, gjëndje të pakushtezuara të Banka qëndrore, llogari rrjedhëse dhe depozita me afat maturimi më pak se tre muaj, të cilat nuk ndikohen shumë nga ndryshimet në vlerën e drejtë dhe përdoren nga Banka për administrimin e angazhimeve afat shkurtra.

Aktivitet monetare dhe ekuivalente me to mbahen me koston e amortizuar në bilanc.

BANKA CREDINS SH.A.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

h) Huatë dhe paradhëniet klientëve

Huatë dhe paradhëniet janë aktive financiare jo-derivativë, me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe Banka nuk ka për qëllim t'i shesë në periudhë afatshkurtër.

Kur Banka është qiradhënësi në një kontratë qiraje, ku transferon në mënyrë thelbësore të gjitha risqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë e mjetit, marrëveshja paraqitet si hua dhe paradhënie dhënë klientëve.

Kur Banka blen një aktiv financiar dhe njëherësh hyn në një marrëveshje për ta rishitur këtë aktiv (ose një aktiv kryesisht të ngjashëm) me një çmim të fiksuar në një datë të ardhshme (marrëveshje të anasjellta të riblerjes ose huadhënie të siguruara nga letra me vlerë), marrëveshja kontabilizohet si një hua apo paradhënie dhe aktivet në bazë të marrëveshjes nuk paraqiten në pasqyrat financiare të Bankës.

Huatë dhe paradhëniet fillimisht maten me vlerë të drejtë plus kosto direkte transaksioni dhe në vazhdim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

i) Investime në letra me vlerë

Investimet në letra me vlerë maten me vlerën e tregut duke i shtuar kostot direkte të transaksionit dhe në vijim të kontabilizuara si të mbajtura deri në maturim, me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, ose të mbajtura për shitje.

(i) Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim

Letrat me vlerë të investimit të mbajtura deri në maturim janë aktive jo-derivative me pagesa fikse ose variable dhe një maturitet të përcaktuar dhe që Banka ka një qëllim pozitiv dhe aftësi për ta mbajtur deri në maturitet dhe këto instrumente nuk janë të dezinjuara me vlerë të drejtë me anë të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve ose të vlefshme për shitje.

Investimet që kanë pagesa fikse ose të përcaktuara dhe të cilat kanë për qëllim të mbahen deri në maturim regjistrohen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Çdo shitje ose riklasifikim i shumave të konsiderueshme të investimeve të mbajtura deri në maturim, jo shumë afër maturimit, do të çonte në riklasifikimin e të gjithë portofolit të mbajtur deri në maturim si investim i mbajtur për shitje dhe do ndalonte Bankën për klasifikimin e tyre si investim i mbajtur deri në maturim për periudhen aktuale dhe për dy vitet pasuese.

(ii) Letra me vlerë të vlefshme për shitje

Investime të vlefshme për shitje janë investime jo-derivative të cilat nuk klasifikohen në ndonjë kategori tjetër të aktiveve financiare. Investimet në kapital të cilat nuk janë të kuotuar dhe vlera e drejtë nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, maten me kosto. Te tjerat e vlefshme për shitje mbahen në pasqyrat financiare me vlerën e drejtë të tyre.

Të ardhurat nga interesi regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas metodës së interesit efektiv. Humbjet apo fitimi nga kursi i kembimit me letrat me vlerë të vlefshme për shitje njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Ndryshimet në vlerën e drejtë njihen direkt në kapital deri në momentin që letra me vlerë shitet ose zhvlerësohet, kur vlera progresive e njohur në kapital, kalon si fitim ose humbje në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

BANKA CREDINS SH.A.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

4. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

j) Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara

(i) Njohja dhe matja

Aktivët e qëndrueshme të trupëzuara paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Kostot përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme në blerjen e mjetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Banka përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë puntore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi, dhe kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe kthimit të vendndodhjes në kushtet e duhura. Kur pjesë të aktiveve afatgjata kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elementë të veçanta të aktiveve të qëndrueshme materiale.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të mjetit të qëndrueshëm të trupëzuar njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Bankë, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të mjeteve të qëndrueshme të trupëzuara njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me anën e metodës zbritëse mbi jetën e dobishme të vlerësuar të aktivit përveçse për Aktivet që zhvlerësohen me metodën lineare. Aktivët e marra me qera zhvlerësohen për me të shkurtrën midis kohës së qerasë dhe jetëgjatësisë së aktivit. Toka nuk zhvlerësohet.

Ndërtesa	20 vjet
Kompjutera dhe pajisje informatike	4 vjet
AutoAktive	5 vjet
Mobilje dhe pajisje zyre	5 vjet
Investime në Aktivet e marra me qira	5 deri 20 vjet

Metoda e zhvlerësimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rishikohen në datën e raportimit

BANKA CREDINS SH.A.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

k) Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara

(i) Programe kompjuterike

Programet kompjuterike të blera nga Banka njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Shpenzimet e mëvonshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij mjeti. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhen që ndodhin tëk pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve. Shpenzimi i amortizimit njihet në pasqyrën e të ardhurave në mënyrë lineare gjatë jetës së dobishme ekonomike, prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e programeve kompjuterike është pesë vjet.

(ii) Licensat

Licensat dhe të drejtat e përdorimit blerë nga Banka janë të paraqitura me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi nqs ka. Shpenzimet e mëvonshme kapitalizohen vetëm atëherë kur ato rrisin përfitimet ekonomike të ardhshme të trupëzuara në aktivin me të cilin lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në pasqyrën e të ardhurave kur ndodhin. Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave në bazë lineare mbi jetën e dobishme të licencës që nga data që është e vlefshme për përdorim. Jeta e dobishme e licencave është 10 vjet.

l) Aktive me qira

Qira të tjera janë qira operacionale dhe nuk njihen në bilancin e Bankës.

m) Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të bankës, përveç aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Humbjet nga rënia në vlerë njihen nëse vlera kontabël e një aktivi tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e aktiveve monetare është grupi me i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare në mënyrë të pavarur nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

BANKA CREDINS SH.A.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

m) Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare (vazhdim)

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet çmimit neto të shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e çmuara të ardhshme të Aktiveve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për aktivin.

Humbjet e mëparshme rishikohen për të vlerësuar nëse rënia në vlerë është zbutur. Një humbje anulohet nëse ka evidencë se nuk ka zhvlerësim, dhe ka patur ndryshim në Vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

n) Depozitat dhe borxhi i varur

Depozitat, letrat me vlerë të borxhit dhe borxh i varur janë burimet kryesore të financimit të Bankës. Kur Banka shet një aktiv financiar dhe hyn në një “marrëveshje ri-blerjeje” ose “huadhënie të garantuar” për ta blerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në të ardhmen, marrëveshja kontabilizohet si një depozitë, dhe aktivi vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Banka klasifikon instrumentet kapitale si detyrime financiare ose instrumenta kapitale në përputhje me thelbin e kushteve kontraktuale të instrumentit.

Depozitat, letra me vlerë të borxhit dhe borxh i varur maten fillimisht me vlerën e tregut duke i shtuar kostot e transaksionit dhe në vijim maten me kosto të amortizuara duke përdorur metodën e interesit efektiv përveçse në rastet kur Banka zgjedh që ti mbajë detyrimet me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave.

o) Provigjionet

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që të mira ekonomike do të kërkojnë për shlyerjen e këtij detyrimi. Provigjionet caktohen duke skontuar flukset e pritshme të parave me një normë para tatimit e cila reflekton vlerën e tregut, dhe nëse është e përshtatshme, riskun specifik të detyrimit.

Një provigjion për ristrukturime njihet kur Banka ka aprovuar një plan formal dhe të detajuar ristrukturimi dhe ristrukturimi ka filluar ose është bërë publik. Kostot operacionale të ardhshme nuk mbulohen.

Provigjioni për kontratat “onerous” njihet kur përfitimet e pritura që rrjedhin në Bankë nga një kontratë janë më të vogla sesa kostot e pashmangshme të përmblotjes së detyrimeve që rrjedhin nga kontrata. Provigjioni matet me vlerën aktuale e më të vogël midis kostos së pritur të mbarimit të kontratës dhe kostos së pritur neto të vazhdimit të kontratës. Para sesa ky provigjion të vendoset, Banka njeh çdo humbje nga zhvlerësimi i aktivit që lidhet me kontratën në fjalë.

BANKA CREDINS SH.A.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

p) Garancitë financiare

Garancitë financiare janë kontrata që e detyrojnë Bankën që të bëjë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që lind kur një debitor specifik nuk paguan në afat sipas termave të një instrumenti huadhënës.

Detyrimet për garancitë financiare fillimisht njihen në vlerën e drejtë dhe vlera fillestare amortizohet mbi jetën e garancisë financiare. Detyrimi për garancinë mbahet me vlerën më të lartë midis vlerës me kosto të amortizuar dhe vlerës aktuale të pagesave të pritshme (kur pagesa nën një garanci është bërë e mundëshme). Garancitë financiare përfshihen tek detyrimet e tjera.

q) Përfitimet e punonjësve

(i) Plan pensioni me kontributë të përcaktuara

Banka paguan vetëm kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritet e Sigurimeve Shoqërore janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributesh të përcaktuara për pensione. Kontributet për planin e pensionit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzime kur ato ndodhin.

(ii) Leja vjetore e paguar

Banka njeh si detyrime shumë e përlogaritur të kostos që pritët të paguhet në këmbim të shërbimeve të punëmarrësit për periudhën.

r) Netimi i operacioneve në monedhë të huaj

Kontratat në monedhë të huaj janë marrëveshje për të shkëmbyer shuma specifike të monedhave në një kurs këmbimi specifik “spot” ose “forward”. Shuma nominale e këtyre kontratave nuk paraqet riskun aktual të tregut ose kreditimit të lidhur me këtë produkt.

s) Aktivet për shitje

Aktivitet e qëndrueshme që pritët të gjenerojnë të ardhura kryesisht nga shitja dhe jo nga vazhdimi i përdorimit klasifikohen si të mbajtura për shitje. Menjëherë pas klasifikimit si të mbajtura për shitje, Aktivet vlerësohen në përputhje me politikat kontabël të Bankës. Më pas, Aktivet maten me vlerën më të vogël midis vlerës së mbartur dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes. Humbjet nga zhvlerësimi pas klasifikimit fillestar si të mbajtura për shitje dhe fitimi nga rivlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Fitimet nuk njihen nëse humbjet kumulative nga zhvlerësimi janë më të mëdha në vlerë .

BANKA CREDINS SH.A.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

t) Ri lëshimi i pasqyrave financiare

Më 8 Maj 2009, Drejtimi i Bankës aprovoi dhe lëshoi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008. Pas kësaj date Banka rishikoi llogaritjet e provigjonit për humbje kolektive nga kreditë dhe paradhëniet klientëve për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008 në mënyrë që të jetë në përputhje me SNK 39 “Instrumentat Financiare: Njohja dhe Matja”. Në fillim, Banka vlerësoi fondin për humbje nga kreditë duke matur fondin për humbje nga kreditë specifike si dhe humbje nga kreditë në grup. Aktivet financiare (të mbajtura me kosto të amorizuar) që nuk shfaqën evidence për humbje u grupuan mbi bazën e karakteristikave të ngjashme monetare dhe u vlersuan bashkë për humbje të mundshme. Karakteristikat e ngjashme të riskut nuk u konsideruan në grupim, megjithëse grupimi mbi bazën e karakteristikave të ngjashme të riskut konsiderohet si i përshtatshëm, për shkak të mungesës në të dhënat historike për humbjet nga të gjitha tipet e kredive problematike dhe rritjes së konsiderueshme në portofolin e kredive të vlerësuara në mënyrë specifike gjatë viteve të fundit ku problemet e kredive shfaqen më vonë gjatë ripagimit.

Më pas Banka rishikoi metodologjinë duke i grupuar aktivet financiare sipas karakteristikave të ngjashme të riskut që janë tregues të aftësisë paguese të kredimarrësit për të ripaguar kredinë sipas kontratës dhe korrigjoi pasqyrat financiare. Rakordimi i pasqyarvefinanciare të rilesuara me ato të datës 8 Maj 2009 vijon si më poshtë:

Gjendja më 31 Dhjetor 2008				
	Tatimi i shtyrë neto	Hua dhe paradhënie klientëve	Fitimi neto për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008	Kapitali aksioner më 31 Dhjetor 2008
Siç raportuar më parë	41,412	24,539,136	867,327	3,243,961
Korigjimi i fondit për humbje nga kredi dhe paradhënie klientëve	-	(103,003)	(142,660)	(103,003)
Korigjimi i tatimit të shtyrë	10,300	-	14,266	10,300
Korigjuar në	51,712	24,436,133	738,933	3,151,258
Gjendja më 31 Dhjetor 2007				
	Tatimi i shtyrë neto	Hua dhe paradhënie klientëve	Fitimi neto për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2007	Kapitali aksioner më 31 Dhjetor 2007
Siç raportuar më parë	37,255	15,824,435	347,796	1,879,182
Korigjimi i fondit për humbje nga kredi dhe paradhënie klientëve	-	39,656	32,887	39,656
Korigjimi i tatimit të shtyrë	(3,966)	-	(2,612)	(3,966)
Korigjuar në	33,289	15,864,091	378,071	1,914,872

BANKA CREDINS SH.A.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

u) Standarte, interpretime dhe amendime të reja ndaj Standarteve të publikuara që nuk janë akoma efektive dhe që janë relevante ndaj aktiviteteve të Bankës

Një sërë standartesh të reja, amendime apo interpretime të tyre ende nuk janë bere efektive për vitin që mbyllet me 31 Dhjetor 2008, dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare:

- KIRFN 13 *Programet e Besnikërisë së Klientëve* shpjegon se si njësitet ekonomike që dhurojnë pikë krediti për besnikërinë e klientëve që blejnë mallra apo shërbime duhet të kontabilizojnë për detyrimin që kanë për të siguruar mallra ose shërbime falas ose me ulje (dhurata) ndaj klientëve të cilët do t'i kërkojnë ato kreditë. KIRFN 13 bëhet e detyrueshme për pasqyrat financiare të Bankës në 2009 dhe do të jetë e aplikueshme retrospektivisht. Drejtimi i Bankës nuk beson se kjo do të ketë impakt në veprimtarinë e Bankës.

- Rishikimi i SNRF 2 *Pagesa e Bazuara në Aksione - Të drejta pensioni dhe anulimet* sqaron përkufizimin e konditave të kushtëzimit dhe prezanton konceptin e konditave jo-kushtëzuese, kërkon që konditat jo-kushtëzuese të reflektohen me vlerën e drejtë në datën e dhënies si dhe pasqyron trajtimin kontabël për konditat jo-kushtëzuese dhe anulimet. Ndryshimet në SNRF 2 do të bëhen të detyrueshme për pasqyrat financiare të Bankës në 2009. Ndryshimet nuk janë relevante për veprimtaritë e saj pasi Banka nuk ka ndonjë plan kompensimi të pagesave të përbashkëta për personelin apo drejtorat e saj.

- SNRF 3 i rishikuar, *Kombinimet e Biznesit* (efektive për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 Korriku 2009) përfshin një sërë ndryshimesh që mund të jenë domethënëse për pasqyrat e Bankës:

- o Përkufizimi i biznesit është zgjeruar duke përfshirë më shumë blerje biznesesh në trajtimin e kombinimeve të biznesit.
- o Ndryshime të mëvonshme në elementët e kushtëzuara do të njihen në pasqyrën e të ardhurave.
- o Kostot e transaksionit, përveç kostove të emetimit të aksioneve dhe instrumenteve të borxhit, do të njihen kur ndodhin.
- o Interesat e mëparshme në biznesin e blerë maten në vlerën e tyre të drejtë, dhe fitim humbjen njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
- o Të gjitha elementët e transferuara nga blerësi, njihen dhe maten me vlerën e drejtë në datën e blerjes, duke përfshirë edhe elementë të kushtëzuar.
- o Blerësi mund të zgjedhë të masë interesat e pakicës me vlerën e drejtë në datën e blerjes (emrin e mirë të plotë), ose interesin e tij proporcional në vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve të identifikuara të shitësit, mbi bazë transaksion pas transaksioni.

SNRF 3 i rishikuar nuk është i aplikueshëm për veprimtaritë e Bankës duke qenë se Banka nuk ka ndonjë interes në filiale që do të ndikohen nga rishikimi i këtij Standardi.

- SNRF 8 *Segmentet Operative* prezanton “sjelljen e Drejtimit” për segmentin raportues. SNRF 8, e cila bëhet e detyrueshme për pasqyrat financiare të Bankës për vitin 2009, do të kërkojë një ndryshim në prezantimin dhe notat shpjeguese të segmentit të informacionit bazuar në raporte të brendshme që kontrollohen në mënyrë të rregullt nga “vendimarrësi kryesor i aktiviteteve të Bankës” në mënyrë që të vlerësojë performancën e çdo segmenti dhe t’iu shpërndajë atyre burime. Banka është aktualisht në procesin e vlerësimit të efektit potencial të këtij standardi në raportimin e segmentuar të Bankës.

BANKA CREDINS SH.A.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

u) Standarte, interpretime dhe amendime të reja ndaj Standarteve të publikuara që nuk janë akoma efektive dhe që janë relevante ndaj aktiviteteve të bankës (vazhdim)

▪ SNK 1 i rishikuar *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* (efektive që nga 1 janari 2009) i cili paraqet termin “të ardhura përmbledhëse totale”, që shfaqin ndryshime në kapital gjatë një periudhe e janë të ndryshme nga transaksionet me ortakë në kapacitetin e tyre si ortakë. Pasqyra totale e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe përbërësit e të ardhurave të tjera përmbledhëse mund të paraqiten qoftë në një pasqyrë të vetme të të ardhurave përmbledhëse (duke kombinuar efektivisht pasqyrën e të ardhurave dhe të gjitha ndryshimet në kapital që nuk i përkasin pronarit në një pasqyrë të vetme), ose në dy pasqyra të ndryshme (një pasqyrë e veçantë e të ardhurave e ndjekur nga një pasqyrë për të ardhurat përmbledhëse). SNK 1 i rishikuar do të bëhet i detyrueshëm për pasqyrat financiare të Bankës në 2009, dhe pritet të ketë një impakt në prezantimin e pasqyrave financiare të Bankës sepse Banka planifikon të prezantojë një pasqyrë të vetme të të ardhurave gjithëpërfshirëse për pasqyrat financiare të vitit 2009.

▪ SNK 23 i rishikuar *Kostot e Huamarrjes* heq mundësinë për të shpenzuar kostot e huamarrjes dhe kërkon kapitalizmin e kostove të huamarrjes që lidhen me aktivet e kualifikuara (ato që kërkojnë një kohë të gjatë për të qenë gati për qëllim përdorimi apo shitje). SNK 23 i rishikuar nuk është i aplikueshëm për operacionet e Bankës sepse ajo nuk ka ndonjë aktiv të kualifikuar për të cilin kostot e huasë të kapitalizohen. SNK 23 i rishikuar do të bëhet i detyrueshëm për pasqyrat financiare të Bankës në 2009 dhe do të përbëjë një ndryshim politikash për Bankën. Në përputhje me kërkesat për kalimin në SNRF, Banka do të aplikojë SNK 23 e rishikuar për aktivet e kualifikuara për të cilat kapitalizmi i kostove të huave fillon në ose mbas datës efektive. Meqënëse Banka nuk ka ndonjë aktiv të kualifikuar, kjo nuk do të ketë efekt në periudhat e mëparshme të Bankës për pasqyrat financiare të vitit 2009.

▪ Rishikimi i SNK 27 *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe të Veçanta* kërkon që ndryshimi në pronësinë e një filiali pa humbur kontrollin mbi të, të kontabilizohet si një transaksion kapitali. Kur Banka humbet kontrollin mbi një filial, çdo interes i mbajtur mbi filialin duhet të vlerësohet me vlerë të drejtë dhe fitimet dhe humbjet do të njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Rishikimet e SNK 27 do të bëhet i detyrueshëm për pasqyrat financiare të Bankës në 2010 dhe nuk pritet të ketë ndonjë efekt në pasqyra të saj.

▪ Rishikimi i SNK 32 *Instrumentat Financiar* dhe SNK 1, *Paraqitja e Pasqyrave Financiare*, kërkon që instrumentat e vendosjes që e detyrojnë Bankën të transferoj aksione mbi aktivet neto të njësisë në likuidim një pale të tretë, të prezantohen si kapital nëse plotësohen disa kushte. Rishikimi do të bëhet i detyrueshëm për pasqyrat financiare të Bankës në 2009 me aplikim retrospektiv dhe nuk pritet të ketë ndonjë efekt në pasqyrat e saj.

Bordi i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ka bërë disa amendime në standartet ekzistuese. Datat efektive për këto amendime ndryshojnë sipas standarteve dhe shumica do të jenë të aplikueshme në pasqyrat financiare të Bankës në vitin 2009. Banka nuk pret ndonjë ndikim të madh të këtyre amendimeve mbi pasqyrat financiare.

▪ Rishikimi i SNK 39, *Instrumentët Financiarë: Njohja dhe Matja* sqaron aplikimin e parimeve ekzistuese që përcaktojnë nëse rreziqe specifike ose pjesë të flukseve monetare janë të pranueshëm të përcaktohen në një marrëdhënie mbrojtje “hedging”. Rishikimi i SNK 39 do të bëhet i detyrueshëm për pasqyrat financiare të Bankës në 2010, me aplikim retrospektiv. Banka është aktualisht në procesin e vlerësimit të efektit potencial të këtij rishikimi.

BANKA CREDINS SH.A.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

u) Standarte, interpretime dhe amendime të reja ndaj Standarteve tepublikuara që nuk efektive akoma dhe që janë relevante ndaj aktiviteteve të bankës (vazhdim)

• KIRFN 15 *Marrëveshjet për Ndërtimin e Pasurive të Patundshme* (e detyrueshme për periudhat pas 1 Janar 2009) sqaron se të ardhurat që rrjedhin nga marrëveshjet për ndërtimin e pasurive të patundshme njihen duke iu referuar fazës së realizimit të kontratës në rastet e mëposhtme:

- marrëveshja përmbush përcaktimin e një kontratë ndërtimi në përputhje me SNK 11.3;
- marrëveshja është vetëm për sigurimin e shërbimeve në përputhje me SNK 18 (p.sh., njësia ekonomike nuk kërkohet të furnizojë me materiale ndërtimi); dhe
- marrëveshja është për shitjen e mallrave por kriteri i njohjes së të ardhurave sipas SNK 18.14 përmbushen ndërsa ndërtimi vazhdon p.sh. në përfundim të punimeve të ndërtimit ose në dorëzim).

KIRFN 15 dhe nuk është relevant për veprimtarinë e Bankës meqë ajo nuk siguron shërbime në ndërtimin e pasurive të patundshme dhe as nuk ndërton pasuri të paluajtshme për qëllime shitje.

• KIRFN 16 *Mbrojtja e një Investim Neto në Veprimtaritë e Huaja* shpjegon se:

- mbrojtja e investimit neto mund të përdoret vetëm për diferencat nga kurset e këmbimit që lindin midis monedhës funksionale të një operacioni dhe monedhës funksionale të njësisë ekonomike dhe vetëm në shumën e barabartë me ose më pak se aktivet neto të veprimtarisë të huaj.
- instrumenti i mbrojtur mund të mbahet nga çdo njësi ekonomike brenda grupit përveç operacioneve të huaja që janë mbrojtur
- me shitjen/nxjerrjen jashtë përdorimi të një operacioni mbrojtës, fitimi ose humbja kumulative tek instrumentat mbrojtës që është përcaktuar të jetë efektiv është klasifikuar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Interpretimi e lejon një njësi ekonomike që përdor një metodë hap-pas-hapi të konsolidimit për zgjedhjen e politikave kontabël për të përcaktuar axhustimin kumulativ të kthimit të monedhës që është klasifikuar në humbje ose fitim nga nxjerrja jashtë përdorimi e një investimi neto nëse është përdorur metoda direkte. KIRFN 16, që do bëhet e detyrueshme për përgatitjen e pasqyrave financiare të Bankës për 2009, aplikohet në mënyrë prospektive në marrëdhëniet mbrojtëse dhe investimeve neto. Interpretimi nuk pritet të ketë ndonjë në pasqyrat financiare.

KIRFN 17 *Shpërndarja e aktiveve jo-monetare pronarëve* (efektive për periudha që fillojnë në ose pas 15 Korrikut 2009) aplikohet për shpërndarjen jo-reciproke të aktiveve jo-monetare ndaj pronarëve në kapacitetin e tyre si pronarë. Në përputhje me Interpretimin, një detyrim për të paguar dividend duhet të njihet kur dividendi është autorizuar siç duhet dhe duhet të matet me vlerën e drejtë të aktiveve që do të shpërndahen. Vlera kontabël e dividendit të pagueshëm duhet të vlerësohet në çdo datë raportimi, dhe ndryshim në vlerën kontabël njihen në kapital si korrigjim i vlerës për shpërndarje. Kur dividendi i pagueshëm shlyhet, diferenca (nëse ka) midis vlerës kontabël të aktiveve të shpërndara dhe vlerës kontabël të dividendëve të pagueshëm do të njihet në pasqyrën e të ardhurave. Meqenëse Interpretimi është i aplikueshëm vetëm prej datës së hyrje në fuqi, ai nuk do të ketë ndikim në pasqyrat financiare për periudhat e mëparshme përpara datës së adoptimit të interpretimit. Për më shumë, meqenëse ai lidhet me dividendët e ardhshëm që do të jenë në zgjedhje të lirë të bordit të drejtorëve/aksionarëve, nuk është e mundur që të përcaktohet efekti i aplikimit në mënyrë paraprake.

BANKA CREDINS SH.A.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

u) Standarte, interpretime dhe amendime të reja ndaj Standarteve tepublikuara që nuk efektive akoma dhe që janë relevante ndaj aktiviteteve të bankës (vazhdim)

▪ SNK 40, Prona për investime (efektive për periudha vjetore duke filluar nga dhe pas 1 Janar 2009). SNK 40 është rishikuar që të përfshijë edhe pronat në ndërtim ose zhvillimin për përdorim të ardhshëm si pronë për investim në përcaktimin e saj si “Pronë për investim”. Këto rezultate që përfshihen në qëllimin e SNK 40, më parë trajtoheshin sipas SNK 16. Ky interpretim nuk pritet të ketë ndonjë ndikim në pasqyrat financiare.

BANKA CREDINS SH.A.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

4. Administrimi i riskut financiar

a) Të përgjithshme

Përdorimi i instrumentave financiarë e ekspozojnë Bankën ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- risku i kreditimit
- risku i likuiditetit
- risku i tregut
- risku operacional

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Bankës ndaj çdo risku të përmendur më lart, objektivat, politikat dhe proceset për vlerësimin dhe administrimin e rezikut, dhe administrimin e kapitalit të Bankës.

Struktura e administrimit të riskut

Bordi Drejtues ka përgjegjësi për ndërtimin dhe vëzhgimin e strukturës së administrimit të riskut. Bordi ka themeluar Komitetin e Aktiveve dhe Detyrimeve (ALCO) dhe Komitetin e Kredisë së Bankës, e atë Operacional, të cilët janë përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të administrimit të riskut në fushat e tyre specifike për të paravendosur limitet e ekspozimit.

Politikat e administrimit të riskut janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga Banka, për të vendosur kufizime dhe kontrole, dhe për të monitoruar zbatimin e ketyre kontroleve. Politikat e administrimit të riskut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet, produktet dhe shërbimet e tregut. Banka, nëpërmjet trajnimeve dhe standarteve dhe procedurave drejtuese, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv, në të cilin çdo punonjës do kuptojë rolin dhe detyrimet përkatëse.

Komiteti i kontrollit është përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë me politikat dhe procedurat e administrimit të riskut dhe për të vlerësuar mjaftueshmërinë e strukturës së administrimit të riskut në lidhje me rreziqet e hasura nga Banka. Komiteti i kontrollit mbështetet nga kontrolli i brendshëm i Bankës për të kryer funksionet e veta. Kontrolli i brendshëm vëzhgon në mënyrë të rregullt dhe 'ad-hoc' politikat dhe procedurat e administrimit të riskut, dhe raporton rezultatet e vëzhgimeve tek Komiteti i Kontrollit.

b) Risku i kreditit

Risku i kreditimit është risku i humbjes financiare i Bankës nëse klienti apo pala tjetër në një instrument financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga instrumenti. Ky risk vjen kryesisht nga kreditë dhe paradhëniet klientëve, bankave dhe investimi në letra me vlerë. Për qëllime të administrimit të riskut të kredisë, Banka konsideron të gjitha elementët e ekspozimit ndaj riskut të kredisë (si risku që rrjedh nga vet klienti, pozicioni gjeografik dhe sektori).

Risku kreditues që rrjedh nga tregtimi i letrave me vlerë mbahet në nivele të ulta sepse përbëhet vetëm nga letra me vlerë shtetërore, Bono dhe obligacione thesari që janë konsideruar si instrumenta pa risk.

Bordi i drejtuesve ka deleguar përgjegjësinë për administrimin e riskut tek Komiteti i Kreditimit të Bankës për ekspozimet e riskut më të mëdha sesa 10% e kapitalit rregullues. Bordi i drejtorëve në bashkëpunim me Komitetin e Kredisë janë përgjegjës për mbikëqyrjen e riskut të kreditit të Bankës duke përfshirë:

BANKA CREDINS SH.A.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

4. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

b) Risku i kreditimit (vazhdim)

Formulimin e politikave të kreditimit duke u konsultuar me njësitë e biznesit, duke mbuluar kërkesat për kolateral, vlerësimin e kredive, vlerësimin dhe raportimin e riskut, dhe përputhshmërinë me ligjet dhe procedurat ligjore në fuqi.

Themelimin e strukturës autorizuese për aprovimin dhe rinovimin e faciliteteve. Limitet e aprovimit i janë shpërndarë Komitetit të Kreditimit dhe Drejtuesit të Departamentit të Korporatave, SME-ve dhe Kreditimit Individual respektivisht. Për shuma më të mëdha kërkohet aprovimi i Komitetit të Kreditimit ose i Bordit të Drejtorëve si të gjykohet më e përshtatshme.

Mbikqyrjen dhe vlerësimin e riskut të kreditimit. Banka vlerëson të gjitha ekspozimet ndaj riskut të kreditimit të cilat e kalojnë kufirin e vendosur, para aprovimit përfundimtar të disbursimit. Rinovimet dhe rishikimet e faciliteteve janë subjekt i të njëjtit proces.

Kufizimi i përqëndrimit të ekspozimit ndaj palëve të treta, industrive të ndryshme, monedhave dhe maturitetit

Zhvillimin dhe përdormin e sistemit të vlerësimit të riskut të Bankës në mënyrë që të kategorizojë ekspozimin në bazë të shkallës së riskut të humbjeve financiare, dhe të fokusojë Drejtimin në rreziqet aktuale të Bankës. Sistemi i kategorizimit të riskut përdoret për të përcaktuar se kur duhet të krijohen fonde për zhvlerësime të mundshme kundrejt ekspozimeve specifike ndaj riskut të kreditimit. Sistemi aktual i kategorizimit të riskut konsiston prej pesë kategorish në përputhje me rregulloren e “Administrimit të Riskut të kreditimit” të Bankës së Shqipërisë të cilat reflektojnë shkallën e riskut të mospagimit dhe vlefshmërinë e kolateraleve, ose lehtësime të tjera të riskut të kreditimit. Përgjegjësia për të caktuar nivelet e riskut i takon Komitetit të kreditimit dhe janë subjekt i monitorimit mujor.

Monitorimin e zbatimit të kufijve të aprovuar të ekspozimit nga njësitë e biznesit, duke përfshirë dhe ato për industritë e zgjedhura, riskut të shtetit dhe llojeve të produktëve. Komiteti i Kreditimit të Bankës merr dhe shqyrton rregullisht raporte mbi cilësinë e kreditimit dhe ndërmer veprime përkatëse korrigjuese.

Sigurimin e këshillave, udhëzimeve dhe aftësi të specializuara njësive të biznesit për të zhvilluar praktikatat më të mira për administrimin e riskut të kreditimit në të gjithë Bankën.

Çdo njësi biznesi duhet të zbatojë politikat dhe procedurat e Bankës për administrimin e riskut të kreditimit autorizuar nga Komiteti i Kreditimit. Çdo njësi biznesi/degë ka një shef për riskun e kreditimit i cili raporton për të gjitha çështjet lidhur me riskun e kredisë tek administrimi lokal i Bankës dhe tek Komiteti i Kreditit të Bankës. çdo njësi biznesi/degë është përgjegjës për cilësinë dhe performancën e portofolit të tij të kredive duke përfshirë edhe ato me aprovimin nga qendra.

Kontrolle të rregullta të njësive të biznesit dhe të proceseve të kreditimit të Bankës ndërmerren nga Kontrolli i Brendshëm.

BANKA CREDINS SH.A.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

4. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

b) Risku i kreditimit (vazhdim)

Ekspozimi ndaj riskut të kreditimit

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2008	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2007
<i>Hua dhe paradhënie klientëve</i>		
<i>Të zhvlerësuara individualisht</i>		
Standarde	660,703	621,501
Në ndjekje	837,606	111,736
Nën standarte	447,043	196,311
E dyshimtë	14,453	25,614
E humbur	66,509	41,205
<i>Vlera bruto</i>	<i>2,026,314</i>	<i>996,367</i>
Humbje për rënie në vlerë nga zhvlerësimi	(301,320)	(150,606)
<i>Vlera neto</i>	<i>1,724,994</i>	<i>845,761</i>
<i>Të zhvlerësuara në grup</i>		
Standarde	22,049,442	14,394,491
Në ndjekje	572,108	493,040
Nën standarte	243,343	144,251
E dyshimtë	45,968	10,972
E humbur	54,149	34,924
<i>Vlera bruto</i>	<i>22,965,010</i>	<i>15,077,678</i>
Humbje për rënie në vlerë nga zhvlerësimi	(253,871)	(59,348)
<i>Vlera neto</i>	<i>22,711,139</i>	<i>15,018,330</i>
Totali i vlerës neto	24,436,133	15,864,091
<i>Hua dhënë bankave</i>		
<i>As me vonesë e as të zhvlerësuara</i>		
Standarde	748,214	1,420,529
Totali i vlerës neto	748,214	1,420,529
<i>Investime në instrumenta financiarë</i>		
<i>As me vonesë ose të zhvlerësuara</i>		
Standarde	3,891,698	6,429,493
Totali i vlerës neto	3,891,698	6,429,493

BANKA CREDINS SH.A.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

4. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

b) Risku i kreditimit (vazhdim)

Hua dhe letra me vlerë të zhvlerësuar

Hua dhe letra me vlerë të zhvlerësuar janë ato hua dhe letra me vlerë për të cilat Banka ka përcaktuar se është e mundur që ajo mos të arkëtojë të gjithë shumën e interesit dhe të huasë në bazë të kushteve të kontratës.

Fondi për humbje nga zhvlerësimi

Banka krijon një fond për humbjet nga zhvlerësimet që përfaqëson vlerësimin e Bankës për humbjet e ndodhura të portofolit. Përbërësit kryesorë të këtij provigjoni janë, një komponent për humbjet specifike që lidhet me ekspozimet e konsiderueshme, dhe një provigjion të përgjithshëm për grupet e aktiveve të ngjashme në lidhje me humbjet e realizuara por që nuk janë identifikuar në huatë që janë subjekt i vlerësimit individual për zhvlerësime.

Politikat e nxjerrjes nga bilanci

Banka nxjerr jashtë bilancit një hua/letër me vlerë (dhe çdo fond për humbjet nga zhvlerësimi) kur Bordi i Drejtorëve të Bankës vendos që huatë/ letrat me vlerë janë të pa arkëtueshme si dhe procesi ligjor për ripagimin e kredisë ka përfunduar dhe klienti vazhdon të mbetet debitor për pjesën e papaguar të huasë.

Më poshtë është paraqitur analiza e shumave neto dhe bruto (e fondit për zhvlerësim) të aktiveve individualisht të zhvlerësuar, sipas shkallës së riskut.

	Hua dhe paradhënie klientëve	
	Bruto	Neto
31 Dhjetor 2008		
Standarde: Të zhvlerësuar individualisht	660,703	609,594
Në ndjekje: Të zhvlerësuar individualisht	837,606	716,879
Nën standarte: Të zhvlerësuar individualisht	447,043	332,798
E dyshimtë: Të zhvlerësuar individualisht	14,453	11,690
E humbur: Të zhvlerësuar individualisht	66,509	54,033
Totali	2,026,314	1,724,994
31 Dhjetor 2007		
Standarde: Të zhvlerësuar individualisht	621,501	521,622
Në ndjekje: Të zhvlerësuar individualisht	111,736	96,862
Nën standarte: Të zhvlerësuar individualisht	196,311	173,136
E dyshimtë: Të zhvlerësuar individualisht	25,614	23,375
E humbur: Të zhvlerësuar individualisht	41,205	30,766
Totali	996,367	845,761

BANKA CREDINS SH.A.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

4. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

b) Risku i kreditimit (vazhdim)

Banka mban kolateral ndaj kredive dhe paradhënies të klientëve në formën pengut të pasurisë, siguri të tjera të regjistruara ndaj aktiveve dhe garanci. Llogaritjet e vlerës së drejtë të kolateralit të vlerësuar në kohën e huasë zakonisht nuk janë freskuar përveç rastit kur një kredi është vlerësuar si e zhvlerësuar. Zakonisht nuk mbahet kolateral mbi kreditë dhe paradhëniet ndaj bankave. Kolateral nuk mbahet ndaj investimeve në instrumentat financiare dhe nuk është mbajtur ndonjë kolateral i tillë për fundvitin e 31 Dhjetor 2008 ose 2007.

Një llogaritje e vlerës së drejtë të kolateralit dhe instrumentave financiare të mbajtura ndaj aktiveve financiare është paraqitur më poshtë:

	31 Dhjetor 2008	31 Dhjetor 2007
<i>Ndaj huave individualisht të zhvlerësuar</i>		
Prona	2,364,314	1,189,592
Të tjera	21,599	6,000
<i>Ndaj huave i të zhvlerësuar mbi në grup</i>		
Prona	74,044,638	32,770,064
Të tjera	23,634,104	15,348,270
Totali	100,064,655	49,313,926

Banka monitoron riskun e përqëndrimit të kredisë sipas sektorëve, sipas maturitetit dhe sipas monedhës. Një analizë e përqëndrimit të riskut të kreditimit në datën e raportimit është si më poshtë:

Hua dhe paradhënie dhënë klientëve	31 Dhjetor 2008	31 Dhjetor 2007
Tregëti	6,214,579	4,195,378
Ndërtim	5,926,997	4,350,217
Kredi konsumatore	4,437,964	2,535,323
Sherbime kolektive, sociale dhe individuale	2,800,188	1,552,404
Industria përpunuese	1,680,895	1,613,795
Hotele dhe restorante	1,268,066	1,203,704
Prodhim dhe shpërndarje energji elektrike etj.	1,234,908	112,778
Pasuri e patundshme	388,036	28,342
Transport dhe komunikim	283,799	63,153
Aktivitetet financiare	221,710	17,931
Agrikulturë	205,363	67,283
Industri punime minerale	73,348	80,240
Aktivitet social dhe shëndetësor	48,002	54,927
Peshkim	-	2,288
Të tjera	207,469	196,282
Totali	24,991,324	16,074,045

BANKA CREDINS SH.A.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

4. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

c) Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Banka nuk do të permbushë pagesën e angazhimeve që lindin nga detyrimet financiare

Administrimi i riskut të likuiditetit

Qëndrimi i Bankës në administrimin e likuiditetit është të sigurojë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet si në kushte normale ashtu edhe në kushte të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo të riskojë të dëmtojë emrin e saj.

Likuiditeti afat-shkurter administrohet nga Departamenti i Thesarit, ndersa likuiditeti afat-mesëm dhe afat-gjatë administrohet nga ALCO. Departamenti i Menaxhimit të Riskut raporton në mënyrë periodike tek ALCO dhe Departamenti i Thesarit mbi ekspozimin ndaj riskut të likuiditetit.

Departamenti i Thesarit mban një portofol aktivesh me likuiditet afat-shkurtër, përbërë nga letra me vlera me maturim afatshkurter, hua dhe paradhënie ndaj bankave të tjera dhe facilitete të tjera ndërbankare, për të siguruar një nivel të mjaftueshëm likuiditeti të Bankës.

Raportet ditore të Thesarit si edhe ato javore e mujore të Departamentit të Menaxhimit të Riskut mbulojnë pozicionin e likuiditetit të Bankës. Të gjitha politikat dhe procedurat janë subjekt i rishikimeve dhe aprovimeve nga ALCO.

Ekspozimi ndaj riskut të likuiditetit

Mënyrat kryesore të përdorura nga Banka për administrimin e riskut të likuiditetit janë raportet e likuiditetit dhe vlerësimi i hendekut për periudha specifike.

Volatiliteti në tregjet financiare globale dhe shqiptare.

Vazhdimi i krizes financiare dhe ekonomike botërore ka ndikim midis të tjerash edhe mbi zvogëlimin e tregjeve kapitale, uljen e likuiditetit në sistemin bankar dhe, në momente specifike, edhe në rritjen e interesit të kreditimit ndërbankar dhe volatilitetin e tregjet të letrave me vlerë. Zhvillime të tjera jo të favorshme të krizës mund të ndikojnë negativisht mbi pozicionin financiar dhe likuiditetin e Bankës.

Banka përllëgarit mbi baza javore këto raporte: raportin e aktiveve likuide mbi detyrimet afat-shkurtra, huatë ndaj depozitave dhe aktivet likuide ndaj depozitave. Aktivët likuide përfshijnë paranë dhe ekuivalentet e saj, bonot e thesarit të qeverisë shqiptare dhe çdo depozitë afat-shkurtër në bankat e tjera me maturitet deri në një muaj. Detaje të raporteve të aktiveve likuide ndaj detyrimeve afat-shkurtra janë si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2008	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2007
Mesatarja për periudhën	73.14%	109.90%
Minimumi për periudhën	53.77%	84.50%
Maksimumi për periudhën	98.01%	133.40%

Hendeku i maturitetit për monedhat kryesore përllëgaritet dhe analizohet nga Banka mbi baza njëmuajore. Tabela e mëposhtme tregon një analizë të aktiveve dhe detyrimeve të Bankës më 31 Dhjetor 2008 dhe 31 Dhjetor 2007 mbi bazën e maturitetit të mbetur:

BANKA CREDINS SH.A.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

4. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

c) Risku i likuiditetit (vazhdim)

Maturitetet kontraktuale të mbetura të aktiveve dhe detyrimeve financiare

31 Dhjetor 2008	Deri në 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 deri 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	Totali
Aktivitet financiar							
Aktive monetare dhe ekuivalente me to	6,616,851	204,933	-	-	-	-	6,821,784
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore	647,429	759,279	671,843	976,395	195,621	-	3,250,567
Hua dhënë bankave	210,776	-	261,053	190,385	86,000	-	748,214
Investime në instrumenta financiarë	689,535	913,630	456,480	385,879	1,446,174	-	3,891,698
Hua dhe paradhënie për klientët	2,346,560	1,796,182	1,751,976	3,094,389	11,290,813	4,156,213	24,436,133
Investime të vlefshme për shitje	-	-	-	56,655	-	-	56,655
Aktive të tjera	195,463	-	-	2,670	-	-	198,133
Totali	10,706,614	3,674,024	3,141,352	4,706,373	13,018,608	4,156,213	39,403,184
Financial liabilities							
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	1,241,551	-	-	-	-	-	1,241,551
Detyrime ndaj klientëve	8,370,318	6,818,354	6,658,340	10,785,673	1,939,548	-	34,572,233
Detyrime të tjera	25,659	-	-	-	-	-	25,659
Borxhi i varur	-	22,114	-	-	1,252,856	-	1,274,970
Totali	9,637,528	6,840,468	6,658,340	10,785,673	3,192,404	-	37,114,413
Risku i likuiditetit më 31 Dhjetor 2008	1,069,086	(3,166,444)	(3,516,988)	(6,079,300)	9,826,204	4,156,213	2,288,771
Kumulativ	1,069,086	(2,097,358)	(5,614,346)	(11,693,646)	(1,867,442)	2,288,771	-
31 Dhjetor 2007							
Totali i aktiveve financiare	11,442,528	3,272,032	3,386,158	4,808,223	10,242,964	1,820,713	34,972,618
Totali i detyrimeve financiare	8,128,163	6,786,426	6,585,222	8,710,500	3,562,065	-	33,772,376
Risku i likuiditetit më 31 Dhjetor 2007	3,314,365	(3,514,394)	(3,199,064)	(3,902,277)	6,680,899	1,820,713	1,200,242
Kumulativ	3,314,365	(200,029)	(3,399,093)	(7,301,370)	(620,471)	1,200,242	-

BANKA CREDINS SH.A.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

4. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

d) Risku i tregut

Risku i tregut është risku që ndryshimi në çmimet e tregut, si normat e interesit, çmimet e kapitalit, normat e kursit të këmbimit do të ndikojë në të ardhurat e Bankës apo vlerën e instrumentave financiarë

Administritimi i riskut të tregut

ALCO është përgjegjëse për administrimin e gjithë riskut të tregut. Risku i kursit të këmbimit përlogaritet dhe raportohet nga Departamenti i Administrimit të Riskut mbi baza ditore. Banka e administron riskun duke mbyllur pozicionet e hapura si dhe duke vendosur dhe monitoruar limite mbi pozicionet e hapura. Banka administron riskun e normave të interesit duke përdorur analizën e riçimit të hendekut dhe analizen e marzhit të fitimit për secilën nga monedhat kryesore. Departamenti i Administrimit të Riskut i përpilon keto raporte mbi baza mujore.

Expzimi ndaj riskut të këmbimit

Analiza e aktiveve dhe detyrimeve më 31 Dhjetor 2008 dhe 31 Dhjetor 2007 sipas monedhës origjinale është si më poshtë:

	ALL	USD	EUR	Të tjera	Totali
Aktivet					
Aktive monetare dhe ekuivalente me to	1,771,058	2,442,330	2,280,076	328,320	6,821,784
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore	1,807,217	515,548	927,802	-	3,250,567
Hua dhënë bankave	287,561	218,861	241,792	-	748,214
Hua dhe paradhënie për klientët	12,795,224	3,412,173	8,228,736	-	24,436,133
Investime në instrumenta financiarë	3,891,698	-	-	-	3,891,698
Aktive dhe paisje të trapezuara dhe të patrupëzuara	810,775	-	-	-	810,775
Investime të vlefshme për shitje	56,655	-	-	-	56,655
Tatim i shtyrë	51,712	-	-	-	51,712
Aktive të tjera	176,826	407	20,900	-	198,133
Totali	21,648,726	6,589,319	11,699,306	328,320	40,265,671
Detyrime dhe kapitali aksioner					
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	426,258	59,721	754,573	999	1,241,551
Detyrime ndaj klientëve	19,699,730	5,253,961	9,301,618	316,924	34,572,233
Detyrime të tjera	23,990	-	1,666	3	25,659
Borxhi i varur	-	-	1,274,970	-	1,274,970
Kapitali aksioner	1,346,698	1,293,265	511,295	-	3,151,258
Totali	21,496,676	6,606,947	11,844,122	317,926	40,265,671
Pozicioni neto më 31 Dhjetor 2008	152,050	(17,628)	(144,816)	10,394	-
31 Dhjetor 2007					
Totali i aktiveve	18,427,207	6,924,874	9,949,308	418,877	35,720,266
Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksioner	17,987,787	7,340,505	9,970,706	421,268	35,720,266
Pozicioni neto më 31 Dhjetor 2007	439,420	(415,631)	(21,398)	(2,391)	-

BANKA CREDINS SH.A.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

4. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

d) Risku i tregut (vazhdim)

Ekspozimi ndaj riskut të interesit

Një përmbledhje e pozicionit neto të interesit të Bankës më 31 Dhjetor 2008 dhe 2007 vijon si më poshtë:

31 Dhjetor 2008	Shënime	Deri ne 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 deri 12 muaj	1deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	Të pashpërndara	Vlera e mbetur
Aktivët								
Aktive monetare dhe ekuivalente me to	12	1,946,156	2,734,075	-	-	-	2,141,553	6,821,784
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore	13	1,133,070	507,787	1,267,754	182,966	-	158,990	3,250,567
Hua dhënë bankave	14	193,427	367,856	180,455	4,458	2,018	-	748,214
Hua dhe paradhënie për klientët	15	2,068,029	19,878,991	363,639	1,463,207	87,747	574,520	24,436,133
Investime në instrumenta financiarë	16	690,029	1,414,284	1,687,737	99,648	-	-	3,891,698
Totali i aktiveve		6,030,711	24,902,993	3,499,585	1,750,279	89,765	2,875,063	39,148,396
Detyrimet								
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	22	1,241,551	-	-	-	-	-	1,241,551
Detyrime ndaj klientëve	23	12,125,641	5,382,810	13,438,861	1,939,546	-	1,685,375	34,572,233
Borxhi i varur	24	-	269,714	-	1,005,256	-	-	1,274,970
Totali i detyrimeve		13,367,192	5,652,524	13,438,861	2,944,802	-	1,685,375	37,088,754
Hendeku më 31 Dhjetor 2008		(7,336,481)	19,250,469	(9,939,276)	(1,194,523)	89,765	1,189,688	

BANKA CREDINS SH.A.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

4. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

d) Risku i tregut (vazhdim)

Ekspozimi ndaj riskut të interesit (vazhdim)

31 Dhjetor 2007	Shënime	Deri ne 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 deri 12 muaj	1deri 5 vjet	Mbi 5 vjet	Të pashpërndara	Vlera e mbetur
Aktivët								
Aktive monetare dhe ekuivalente me to	12	7,565,411	761,025	-	-	-	-	8,326,436
Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore	13	894,355	502,381	965,541	255,354	-	166,258	2,783,889
Hua dhënë bankave	14	100,066	1,305,643	14,820	-	-	-	1,420,529
Hua dhe paradhënie për klientët	15	719,979	12,309,102	74,779	1,554,818	915,538	289,875	15,864,091
Investime në instrumenta financiarë	16	840,840	2,111,379	3,074,599	402,675	-	-	6,429,493
Totali i aktiveve		10,120,651	16,989,530	4,129,739	2,212,847	915,538	456,133	34,824,438
Detyrimet								
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	22	1,705,886	-	62,107	-	-	383	1,768,376
Detyrime ndaj klientëve	23	10,309,745	5,559,856	10,685,650	2,826,007	-	1,839,977	31,221,235
Borxhi i varur	24	-	-	-	735,843	-	-	735,843
Totali i detyrimeve		12,015,631	5,559,856	10,747,757	3,561,850	-	1,840,360	33,725,454
Hendeku më 31 Dhjetor 2007		(1,894,980)	11,429,674	(6,618,018)	(1,349,003)	915,538	(1,384,227)	

BANKA CREDINS SH.A.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

4. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

d) Risku i tregut (vazhdim)

Ekspozimi ndaj riskut të interesit(vazhdim)

Për të mbështetur analizën e riçimit të hendeikut, Banka monitoron mbi baza mujore ndjeshmërinë e të ardhurave neto nga interesi për një periudhë një-vjeçare të një zhvendosje paralele në kurbën e normës së kthimit. Një analizë e ndjeshmërisë së Bankës për një rritje ose ulje të normave të interesit të tregut mbi një periudhë një vjeçare (duke supozuar zhvendosje paralele në kurbën e të ardhurave dhe një pozicion konstant të bilancit kontabël) për çdo monedhë është si më poshtë:

Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2008	100 pikë bazë rritje paralele	100 pikë bazë rënie paralele
LEK	10,087	(10,087)
USD	28,934	(28,934)
EURO dhe monedha të tjera	45,731	(45,731)
Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2007	100 pikë bazë rritje paralele	100 pikë bazë rënie paralele
LEK	15,044	(15,044)
USD	16,330	(16,330)
EURO dhe monedha të tjera	5,181	(5,181)

e) Administrimi i kapitalit

Kapitali rregullator

Rregullatori i Bankës, Banka e Shqiperisë, vendos dhe monitoron kërkesat në lidhje me kapitalin matur mbi raportin e mjaftueshmërisë për kapital në përputhje me Rregulloren mbi Mjaftueshmerinë e Kapitalit datë 5 Maj 1999. Raporti i mjaftueshmerisë së kapitalit përlogaritet si përqindje e kapitalit rregullator mbi riskun e ponderuar të aktiveve dhe aktiveve jashtë bilancit kontabël.

Kapitali rregullator i Bankës analizohet në dy kategori:

1. Kapitali bazë, ku përfshihet kapitali i aksioneve të zakonshme, primet e emetimeve dhe bashkimeve; fitimi akumuluar; duke hequr kapitalin aksioner të papaguar, diferencat nga rivlerësimi të perfshira në kapitalin që raportohet për qëllime rregullatore, i cili paraqet ndryshimet e kurseve historike të këmbimit krahasuar me kursin e këmbimit të fund vitit kur kapitali është paguar në një monedhë tjetër nga monedha e raportimit; si dhe Aktivët e patrupëzuara.
2. Kapitali shtesë, i cili përfshin detyrime të varura, rezerva të përgjithshme dhe korrigjime të tjera rregulluese.

BANKA CREDINS SH.A.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

4. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

e) Administrimi i kapitalit (vazhdim)

Kapitali rregullator (vazhdim)

Aktivet e ponderuara me riskun dhe zërat jashtë bilancit përcaktohen në përputhje me nevojat specifike të cilat reflektojnë nivelet e ndryshme të riskut që mbartin aktivet dhe zërat jashtë bilanci.

Banka pranon nevojën për të mbajtur një ekuilibër midis kthimeve të larta që mund të vijnë nga investime me risk të lartë dhe kërkesave për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit mbi 12% i cili është minimumi i raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit kerkuar nga Rregullatori.

Banka ka qënë në përputhje me të gjithë kërkesat për kapital përgjate gjithë periudhës. Nuk ka patur ndryshime të rëndësishme në administrimin e kapitalit të Bankës gjate periudhës.

Gjendja e kapitalit rregullator të Bankës me 31 Dhjetor 2008 dhe 31 Dhjetor 2007 ka qënë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2008	31 Dhjetor 2007
Kapitali bazë		
Kapitali i nënshkruar	2,119,763	1,598,110
Primi i emetimit	258,618	84,814
Rezerva e përgjithshme	336,334	-
Fitimet e mbartura për qëllime rregullator	558,829	531,553
Rezervë rivlerësimi debitore (negative)	(336,993)	(415,418)
Aktive të patrupëzuara	(36,086)	(36,958)
	2,900,465	1,762,101
Kapital shtesë		
Detyrime të varura me afat	1,274,970	735,843
Akte të tjera rregulluese të Bankës së Shqipërisë	-	-
	1,274,970	735,843
Totali i kapitalit rregullator	4,175,442	2,497,944
Aktive të ponderuara me riskun	27,719,732	17,482,773
Ekspozime jashtë bilancit të ponderuara me riskun	1,431,933	1,080,440
Totali	29,151,665	18,563,213
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	14.32%	13.46%
Minimumi i kërkuar i Raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit	12%	12%

Angazhimi i kapitalit

Angazhimi i kapitalit midis aktiviteteve dhe operacioneve specifike, në një shkallë të gjerë, është bërë për të optimizuar kthimin mbi kapitalin e angazhuar. Shuma e kapitalit të angazhuar për çdo aktivitet ose operacion është gjithashtu në varësi të kapitalit rregullator. Proçesi i ndarjes së kapitalit midis operacioneve specifike dhe aktiviteteve vendoset në mënyrë të pavaruar nga personat përgjegjës për operacionet dhe është subjekt i rishikimit nga Komiteti i Kreditit të Bankës ose nga ALCO sipas rastit.

BANKA CREDINS SH.A.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

5. Perdorimi i vlerësimit dhe gjykimit profesional

Banka bën vlerësime dhe supozime përgjatë vitit, të cilat ndikojnë në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme dhe bazohen mbi informacionet e tregut të rëndësishme që disponohen dhe faktorë të tjerë, përfshirë parashikimet për ngjarje të ardhshme të cilat mendohet se janë të arsyeshme për rrethanat.

(i) Fonde të lejuara për humbje nga zhvlerësimi i kredive

Banka rishikon në bazë mujore protofolin e kredisë për të përcaktuar humbjet nga zhvlerësimi. Për të përcaktuar nëse një humbje nga kreditë duhet të regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, Banka gjykon nëse ka ndonjë të dhënë të dukshme e cila tregon se ka rënie të matshme në vlerësimin e flukseve të ardhme hyrëse të parasë nga portofoli i kredive përpara se kjo rënie të identifikohet si humbje nga një kredi specifike e atij portofoli.

Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna të dukshme si një ndryshim i pafavorshëm në gjëndjen e pagava të huamarrësit ndaj Bankës, ose ngjarje ekonomike kombëtare ose lokale të cilat lidhen me mospagimin e kredive.

(ii) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare për të cilat nuk ka çmime tregu të dukshme, kërkon përdorimin e teknikave të vlerësimit të përmendura në politikën kontabël 3(f)(v).

(iii) Llogaritja e tatimit mbi fitimin

Duke filluar nga 1 Janari 2008 Banka ka aplikuar Standartet Nderkombëtare të Raportimit Financiar për përpilimin e pasqyrave për qëllime ligjore. Rrjedhimisht, aplikimi i Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar siguron bazat kryesore për regjistrimet kur një shoqëri është subjekt i tatimit mbi fitimin. Megjithatë, në datën e lëshimit të pasqyrave financiare ekzistojnë disa rishikime të ligjit të tatimit mbi fitimin dhe rregulloreve përkatëse për llogaritjen e tatimit mbi fitimin, të cilat mund të ofrojnë një ndihmë për adoptimin fillestar të Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar si një rregullore për qëllime ligjore. Drejtimi beson se llogaritja e provigjionit për tatimin mbi fitimin është e kujdesshme duke patur parasysh paqartësinë e ambjetit tatimor në Shqipëri dhe ligjin në fuqi, prandaj ndonjë kontroll i mundshëm nga taksat nuk do të ketë ndonjë efekt të rëndësishëm mbi pozicionin financiar të Bankës, rezultatin nga operacionet ose fluksin e parasë.

BANKA CREDINS SH.A.

Shënime shoqëruese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008

(shuma në mijë Lekë, kur nuk është shprehur ndryshe)

6. Paraqitja me vlerën e drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë bazohet mbi instrumentat financiare ekzistues të bilancit kontabël, pa u përpjekur për të aktualizuar vlerën e bizneseve të ardhshme dhe vlerën e aktiveve dhe detyrimeve të cilat nuk janë instrumenta financiare.

